

VENDIM
Nr. 123, datë 13.3.2019

**PËR DHËNIEN E LEJES SË POSAÇME “TRANS ADRIATIC PIPELINE”, AG,
ZVICËR, PËR NDËRTIMIN DHE OPERIMIN E GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK
(TAP) NË TERRITORIN
E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pikat 3.4, paragrafi “ii”, e 3.5; 5, pikat 5.1, 5.2 e 5.3; dhe 45, të “Marrëveshjes me qeverinë e vendit pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP)”, ratifikuar me ligjin nr. 116/2013, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Shoqëria *Trans Adriatic Pipeline*, AG (TAP AG) gjatë operimit të gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) zbaton kërkesat e përcaktuara nga ERE me vendimin nr. 64, datë 13.6.2013, të bordit të komisionerëve të ERE-s, “Për amendimin e vendimit të bordit të komisionerëve të ERE-s, nr. 27, datë 1.3.2013, “Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP-AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41(6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline”, për marrjen në konsideratë të opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr. 1/2013) dhe vendimit të Komisionit Evropian (C(2013) 2949” (vendimi për përjashtim i ERE-s”).

2. Pas marrjes së lejes së posaçme, në përputhje me MQP-në dhe legjislacionin në fuqi, investitori i projektit ka përgjegjësinë të mirëmbajtë gazsjellësin TAP operativ gjatë të gjithë vlefshmërisë së lejes së posaçme.

II. PËRKUFIZIME

Përkufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, në marrëveshjen me qeverinë e vendit pritës (MQP), ratifikuar me ligjin nr. 116/2013, të ndryshuar, dhe në vendimin nr. 713, datë 25.8.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për kushtet e procedurat për dhënien e lejeve për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës së sistemeve të gazit natyror”, zbatohen, për sa janë të aplikueshme në kontekstin e MQP-së, nëse nuk përcaktohet ndryshe në këtë vendim.

Ndërkohë, përkufizimet e mëposhtme kanë kuptimet, si më poshtë vijon:

1. “Mbajtësi i lejes së posaçme”, investitori i projektit;
2. “Lejet dhe licencat ekzistuese”, të gjitha lejet dhe licencat e çfarëdo lloji natyre, të lëshuara për investitorin e projektit nga shteti, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, lidhur me ndërmarrjen e cilësdo veprimtarie të projektit për ndërtimin dhe përdorimin e infrastrukturës shqiptare dhe të sistemit të gazsjellësit në përgjithësi;
3. “Pikë hyrje dhe/ose dalje”, pika/t në infrastrukturën shqiptare, në territorin shqiptar, që do të shërbejnë për marrjen ose futjen dhe transportimin e gazit natyror në sistemin e gazsjellësit.

III. DHËNIA E LEJES SË POSAÇME

1. Investitorit të projektit i jepet kjo leje e posaçme për ndërtimin dhe operimin e gazsjellësit Trans Adriatik dhe të gjithë infrastrukturës shqiptare, që shërben për qëllimet e transmetimit të gazit natyror dhe lidhjes së tij me sistemet e vendeve fqinje, sipas kushteve dhe termave të MQP-së. Sistemi i gazsjellësit është projektuar të funksionojë me një kapacitet transporti që mund të rritet nga kapaciteti fillestar, prej 10 miliardë metrash kub gaz (BCM) në vit, deri në 20 miliardë metra kub gaz (BCM) në vit.

2. Në vijim të MQP-së dhe në përputhje me lejen e posaçme dhe leje të tjera të posaçme vijuese, mbajtësi i lejes së posaçme nuk është i detyruar të themelojë si dhe të veprojë nëpërmjet një shoqërie në Republikën e Shqipërisë, sipas pikave 2, 4, 5, 6, shkronja “a”, dhe 7, të vendimit nr. 713, datë 25.8.2010, të Këshillit të Ministrave, dhe mbajtësit të lejes së posaçme nuk i imponohen kritere të mëtejshme lidhur me statusin e vet të veprimtarisë së biznesit, sipas legjislacionit shqiptar.

3. Kjo leje e posaçme është e zbatueshme lidhur me realizimin, ndërtimin dhe operimin e infrastrukturës shqiptare, në përputhje me skemën e miratuar me vendimin nr. 1, datë 8.4.2014, të Këshillit Kombëtar të Territorit, “Për miratimin e lejes zhvillimore komplekse për gazsjellësin Trans Adriatik (Projekti TAP)”, të ndryshuar, duke përfshirë edhe:

a) ndërtimin e një pike dalëse/hyrëse në afërsi të stacionit të kompresorëve në Topojë, Fier (SKO-3), në përputhje me vendimin nr. 233, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e marrëveshjes së angazhimit për zhvillimin e tregut të gazit dhe të marrëveshjes për përfitimet vendase, të lidhura ndërmjet Republikës së Shqipërisë, e cila vepron nëpërmjet Këshillit të Ministrave, dhe Trans Adriatic Pipeline, AG, lidhur me projektin e gazsjellësit Trans Adriatik.”;

b) një tjetër pikë dalëse/hyrëse, e parashikuar në seksionin 4.7.7, të vendimit të përjashtimit të ERE-s, duke i dhënë përparësi zonës së Kuçovës, qarkut Berat, si dhe çdo pike hyrëse dhe dalëse shtesë, në përputhje me seksionin 4.7.8, të vendimit të përjashtimit të ERE-s, duke përfshirë mundësinë e ofruar nga stacioni matës/kompresor i Bilishtit, Korçë (SKO-2);

4. Kjo leje e posaçme lëshohet për një periudhë 30-vjeçare, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Afati i lejes mund të shtyhet në përputhje me dispozitat e MQP-së;

5. MQP-ja konsiderohet si marrëveshja e referuar në pikën 2, të nenit 11, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, dhe në pikën 18, të vendimit nr. 713, datë 25.8.2010, të Këshillit të Ministrave, që lidhet ndërmjet investitorit të projektit dhe palës shtetërore ose autoritetit të pavarur, lidhur me lejen e posaçme.

6. Çdo kërkesë tjetër, sipas dispozitave ligjore të sipërpërmendura, konsiderohet e përmbushur plotësisht. MQP-ja ka hyrë në fuqi më 11.11.2014 (data efektive), sipas përcaktimit të pikës 2.2, të MQP-së.

IV. TRANSFERIMI I LEJES SË POSAÇME

1. Në përputhje me nenin 45.2, të MQP-së, leja e posaçme, e lëshuar në kuadër të këtij vendimi, mund t’i transferohet nga investitori i projektit, si mbajtësi i lejes së posaçme, çdo pale të tretë, që do të ndërmarrë ato veprimtari të autorizuar të projektit, të cilat lidhen me përdorimin e pjesës shqiptare të infrastrukturës, por vetëm në masën që ky transferim është në përputhje me MQP-në dhe nuk sjell mospërputhje me legjislacionin shqiptar mbi konkurrencën. Leja mund t’i transferohet përsëri investitorit të projektit, sipas zgjedhjes së këtij të fundit.

2. Në përputhje me nenin 45.2, të MQP-së, për qëllimet e transferimit të lejes së posaçme, investitori i projektit, në funksionin e mbajtësit të lejes së posaçme, duhet të marrë, paraprakisht, miratimin e autoriteteve shtetërore, bazuar në kërkesën e investitorit të projektit, miratim, i cili nuk mund të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme dhe që duhet shqyrtuar brenda një periudhe 20-ditore.

V. RINOVIMI I LEJES SË POSAÇME

1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ose çdo pasardhës ligjor i saj në sektorin e hidrokarbureve, përpara përfundimit të afatit të lejes së posaçme (përfshirë të gjitha lejet e posaçme vijuese, të lëshuara në përputhje me nenin 5.3, të MQP-së), pas miratimit me vendim nga Këshilli i Ministrave, i lëshon investitorit të projektit lejen e posaçme vijuese, me të njëjtat terma, kushte dhe kohëzgjatje prej 30 vitesh, pa nevojën e veprimeve nga ana e palëve shtetërore ose autoritetit të pavarur. Dispozitat e pikave 18, shkronja “c”, dhe 27, të vendimit nr. 713, datë 25.8.2010, të Këshillit të Ministrave, (përfshirë të gjitha ndryshimet që mund të ndërmerren në këtë vendim), lidhur me rinovimin e lejes së posaçme, nuk zbatohen për investitorin e projektit.

2. Rinovimi i lejes së posaçme, sipas pikës 1, më lart, nuk kryhet nëse investitori i projektit, jo më vonë se dy vjet përpara përfundimit të afatit të lejes së posaçme dhe në përputhje me dispozitat e MQP-së, i kërkon Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë apo pasardhësit të saj ndërprerjen përfundimtare të veprimtarive të projektit.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Brenda 30 ditëve, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, shoqëria TAP AG ekzekuton pagesën prej 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekësh, të përcaktuar sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 23, të vendimit nr. 713, datë 25.8.2010 të Këshillit të Ministrave.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama